

**A - Lutjes për lëshimin e lejes së parë unike për shkak të zbatimit të shërbimeve jashtë kufirit me punëtorët e dërguar në bazë të pëlqimit të entit për punëtorët e dërguar, të cilët shërbimet i kryejnë jashtë kufirit (neni 22. i Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve)<sup>1</sup> duhet bashkëlidhur:**

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë mbi sigurimin social nga shteti, nga i cili është dërguar, i cili përfshinë edhe sigurimin shëndetësor, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë. Në qoftë se siguri social nga shteti amë nuk përfshinë sigurimin shëndetësor, bashkëlidhet dëshmia mbi sigurimin shëndetësor adekuat, i cili mbulon së paku shërbimet shëndetësore emergjente në Republikën e Sllovenisë.
- dëshminë për mjete të mjaftueshme për mbijetesë;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajit;
- kontratën për zbatimin e shërbimeve për porositësin;
- dëshminë, se punëtorët e dërguar janë së paku nëntë muaj të punësuar tek punëdhënësit të huaj, i cili i dërgon punëtorët në Republikën e Sllovenisë<sup>2</sup>;
- dëshminë mbi regjistrimin e punëdhënësit të huaj.

**Në procedurën e lëshimit të lejes unike njësia administrative dhe Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim sipas detyrës zyrtare do ti sigurojnë të dhënat në vijim:**

- nga evidenca penale, evidenca e aktgjykimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjykimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduara dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

**B – Lutjes për lëshimin ose vazhdimin e lejes unike për shkak të aftësisë në shoqëri ekonomike në Republikën e Sllovenisë në bazë të pëlqimit të entit për punëtorët e dërguar në lëmin e aftësisë të punëtorëve të dërguar dhe punëtorëve slloven në shoqëritë ekonomike të lidhura (neni 24. i Ligjit për punësim, vetëpunësim dhe punë të huajve)<sup>3</sup> duhet bashkëlidhur:**

- fotografinë e të huajit ose numrin referues nga deponimi elektronik i fotografive;
- pasaportën ose fotokopjen e verifikuar të pasaportës së të huajit;
- dëshminë mbi sigurimin social nga shteti, nga i cili është dërguar;

<sup>1</sup> Pëlqimi i entit nuk është i duhur në rast e të huajit, i cili është dërguar në punë në Republikën e Sllovenisë për shkak të zbatimit të shërbimeve jashtë kufirit nga ana e punëdhënësit me seli në një shtet tjetër anëtar të UE ose KEE.

<sup>2</sup> Të huajit nuk i duhet që të bashkëlidh dëshminë, i cili është dërguar në punë në Republikën e Sllovenisë për shkak të zbatimit të shërbimeve jashtë kufirit nga ana e punëdhënësit me seli në një shtet tjetër anëtar të UE ose KEE.

<sup>3</sup> Pëlqimi i entit nuk është i duhur në rast e të huajit, i cili është dërguar në punë në Republikën e Sllovenisë për shkak të zbatimit të shërbimeve jashtë kufirit nga ana e punëdhënësit me seli në një shtet tjetër anëtar të UE ose KEE.

- dëshminë për mjete të mjaftueshme për mbijetesë;
- vërtetimin nga evidenca penale të shtetit amë të huajt gjithmonë në rastin e lutjes për lëshimin e lejes së parë, kurse në rastet tjera, nëse organi kështu kërkon;
- kontratën mbi aftësimin, të kontraktuar midis shoqërisë ekonomike me seli në Republikën e Sllovenisë dhe shoqërisë ekonomike me seli në shtetin e tretë ose në shtetin anëtar të UE ose KEE;
- dëshminë mbi regjistrimin e punëdhënësit të huaj;
- kontratën mbi punësimin me punëdhënësin, me seli në shtetin e tretë ose shtetin anëtar të UE ose KEE, të përkthyer në gjuhën Sllovene;
- dëshminë mbi lidhshmërinë kapitale ose kontratën e lidhur mbi bashkëpunimin afarist-teknik ose për tejkalimin e teknologjisë;
- programi i aftësimin për punëtorët e dërguar;
- pëlqimi i odës kompetente ose asociacionit të punëdhënësve.

Të huajt, i cili është i dërguar në Republikën e Sllovenisë për shkak të aftësimin në shoqërinë ekonomike në Republikën e Sllovenisë nga ana e punëdhënësit me seli në një shtet tjetër anëtar të UE ose EKK nuk është e duhur që ti bashkëlidh dëshmitë nga alineja nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë.

**Në procedurën e lëshimit të lejes unike njësia administrative dhe Enti i Republikës së Sllovenisë për punësim sipas detyrës zyrtare do ti sigurojnë të dhënat si në vijim:**

- nga evidenca penale, evidenca e aktgjyqimeve të plotfuqishme përkatësisht aktvendimeve për kundërvajtjet, të cilat në Republikën e Sllovenisë i mbanë Ministria e drejtësisë;
- nga evidencat për vendimet e plotfuqishme të kundërvajtjeve, të cilat i mbajnë organet për kundërvajtje në Republikën e Sllovenisë;
- mbi aktakuzat e plotfuqishme të depozituara dhe aktgjykimet e jo plotfuqishme të lëshuara, të cilat i mbanë gjykata kompetente;
- nga evidencat, të cilat i mban organi tatimor mbi detyrimet tatimore të jopaguara të skaduar dhe mbi kundërvajtjet tatimore, të cilat janë të shënuara si sekret tatimor.

**Informata lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale:**

- të dhënat personale nga formulari për qëllim të lëshimit të lejes për qëndrim përpunohen në ujdi me nenin 93. të Ligjit për të huajt;
- organi ka të drejtë që të përfitoi edhe të dhëna tjera, nëse kjo është në interesin tuaj dhe se për këtë e keni dhënë pëlqimin ose nëse kjo është e lejuar me ligj, pëlqimin mund ta revokoni kurdoherë pranë organit;
- nëse për këtë janë plotësuar kushtet e parashkuara, keni të drejtë ndaj informimit me të dhënat tuaja personale, të drejtën ndaj përkufizimit të përpunimit dhe të drejtën ndaj kundërshtimit të përpunimit;
- keni të drejtë që të verifikoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, të shënuara në lejen për qëndrim, dhe të drejtën që të kërkonti ndryshimin e tyre ose, nëse për këtë janë të plotësuar kushtet e parashkuara, fshirjen e tyre;
- menaxhuesi i ruan të dhënat tuaja në ujdi me nenin 115. të Ligjit për të huajt;
- kontakti i personit të autorizuar të menaxhuesit për mbrojtjen e të dhënave personale në Ministrinë e punëve të brendshme: posta elektronike: [dpo.mnz@gov.si](mailto:dpo.mnz@gov.si);

- nëse jeni të mendimit, se të dhënat tuaja po përpunohen joligjshëm, mund të ushtroni ankesë pranë Autorizuesit të informimit